



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË



AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE “ HYSEN ÇELA “ DURRËS

Nr. 544 prot.

Durrës 28.08.2023

Lënda: Njoftim për levizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr.14 datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla e mesme teknologjike “Hysen Çela” ju njofton krijimin e vendit të lire (dalje ne pension) per pozicionin

- Pozicioni : mësues i praktikës profesionale drejtimi Ekonomik

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

1.Kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale ne ofruesin e AFP-së që ofrojnë arsim profesional .

- a)Te ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së ,për të cilin /cilat po aplikon .
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a - letërmotivimin për pozicionin;

b- jetëshkrimin (CV-në);

c- kartën e identitetit;

d- diplomën;

e- librezën e punës;

f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;

i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

j- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

k - të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e shkolles së mesme teknologjike "Hysen Çela", brenda datës ... 14.09.2023.

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI

